

Artikulli është botuar në gazetën El-Hilal, viti I, nr. 1, maj 1987, faqe 4.

RRËFIMET KUR'ANORE

Dikmë se Kur'ani përmban rrëfime të ndryshme, në të cilën bën pjesë edhe jistoria ose më mirë të themi rrëfime të ndryshme për pejgamberët dhe popujt (ummetet) e tyre.

Nëse analizojmë veçmas kaptinat (suret) e Kur'ani kerimit, rrallë do të hasim në ndonjë sure e cila nuk përmban diçka për pejgamberët ose popujt e tyre, si dhe ndodhi të ndryshme.

Qëllimi i përmendjes së pejgamberëve në Kur'an

Për qëllimin e përmendjes së pejgamberëve në Kur'an, më së miri na tregon ajeti kur'anor ku thotë:

وَكَلَّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿١٢٠﴾

“Na po t'i tregojmë ty të gjitha lajmet e pejgamberëve, për me ta forcua zemrën. Dhe në këtë sure të ka ardhur ty e vërteta; këshilla dhe të përkujtuarit për besimtarët.” (11:120)

Sipas kësaj të gjitha rrëfimet e Kur'anit për pejgamberët e All-llahut xh. sh. parashtrojnë:

- Të vërtetën e cila buron nga All-llahu xh. sh.,
- Këshilla të cilat do t'i shërbejnë besimtarit në jetën e përditshme dhe
- Vërejtje për besimtarët e drejtë.

Duke pasur parasysh këto ajete, rrëfimet kur'anore për pejgamberët e All-llahut xh. sh. nuk mund t'i quajmë tregime sepse shumë tregime janë të menduara dhe të pavërteta. Ndërsa rrëfimi i pejgamberëve në Kur'an është nga All-llahu xh. sh. dhe paraqet të vërtetën. All-llahu xh. sh. di gjithçka si dhe ndodhitë e hershme. Pa Shpalljen e All-llahut xh. sh. nuk do të dishim kurrëgjë për krijimin e njeriut; Ademin a.s. dhe për pejgamberët tjerë të cilët pasuan.

Pra, përfundojmë se rrëfimet kur'anore nuk i ka menduar Muhammedi a.s. siç mendojnë disa orientalistë dhe kundërshtarë të Islamit. Ata pretendimet e veta i trillojnë, fjala se, Muhammedi a.s. gjatë udhetimeve të ndryshme ka mësuar shumë tregime prej të krishterëve dhe hebrenjëve.

Mirëpo, nëse analizojmë jetën e Muhammedit a.s. para pejgamberllëkut do të konstatojmë se Muhammedi a.s., për në Sham (Damask) ka udhtuar gjithsejtë dy herë; dhe atë, herën e parë u kthye prej Basrës në Mekkë, kurse herën e dytë arriti gjer në Sham. Por kur kemi parasyshë se ai në Sham qëndroi vetëm disa ditë, a thua vallë, ka mundur t’i mësoj tërë rrëfimet që përmend Kur’ani gjatë atij qëndrimi të shkurtër. Gjithashtu takimet e Pejgamberit a.s. me hebrenjtë kanë qenë me karakter të kundërshtarit sepse Muhammedi a.s. u paraqit pejgamber i ri si dhe sulmonte fenë hebraike, prandaj ai nuk mundi të mësoj kurrigjë nga ata, sidomos kur kemi parasyshë Mekkën e cila nuk ishte e banuar as me hebrenj e as me të krishterë. Këtë argumenton ajeti i Kur’anit:

﴿١٠٣﴾ وَلَقَدْ نَعْلَمُ أَنَّهُمْ يَقُولُونَ إِنَّمَا يُعَلِّمُهُ بَشَرٌ لِّسَانُ الَّذِي يُلْحِدُونَ إِلَيْهِ أَعْجَمِيٌّ وَهَذَا لِسَانٌ عَرَبِيٌّ مُبِينٌ ﴿١٠٣﴾

“Na e dimë mirë që ata thonë: “Atë (Muhammedin) e mëson një njeri!” Gjuha e tij, që po ia mveshin – se po e mëson atë – është gjuhë e të huajve (të cilën nuk e dinë arabët), kurse ky (Kur’ani) është në gjuhën e qartë arabe (me një stil të lartë).” (16:103)

Mekka ishte vend ku nuk ishte I organizuar shkollimi, në të nuk studiohej ndonjë shkencë, përveç se organizoheshin gara se kush do të bëhet udhëheqës. Edhe Muhammedi a.s. nuk ka qenë i shkolluar:

﴿٤٨﴾ وَمَا كُنْتَ تَتْلُو مِنْ قَبْلِهِ مِنْ كِتَابٍ وَلَا تَخُطُّهُ بِيَمِينِكَ إِذَا لَأْرْتَابِ الْمُبْتَلُونَ ﴿٤٨﴾

“Dhe ti – para (Kur’anit) nuk ke lexuar kurrfarë libri, e as që ke shkruar me dorën tënde, (se) atëherë, do të dyshonin të degjeneruarit.” (29:48)

Prandaj themi, se rrëfimet kur’anore në thelb përmbanë mrekullinë përmes së cilës vërtetohet pejgmaberllëku i Muhammedit a.s. dhe se Kur’ani është Libër i Shpallur nga All-llahu xh. sh.

Çdo lexues i Kur’anit mund të pyes: prej kah i mësoi Muhammedi a.s. këto rrëfime kur dimë se ai nuk jetoi në kohën kur u zhvilluan ndodhitë e prezentuara në Kur’an madje ai as që dinte shkrim-leximin.

Llojet e rrëfimeve kur’anore

Rrëfimet kur’anore ndahen në tri grupe:

1. Rrëfimet e pejgamberëve – të cilat përmbanë rrëfimet e pejgamberëve, mrekullitë e pejgamberëve, qëndrimin e kundërshtarëve,

etapat e e thirrjes së tyre dhe zhvillimin e saj si dhe përfundimin e besimtarëve dhe të pabesimtarëve. Si p. sh. rrëfimet për Nuhin, Ibrahimin, Musain, Harunin, Isain dhe Muhammedin a.s.

2. Rrëfimet kur'anore të cilat kanë të bëjnë me ndodhitë e kaluara, individ të cilët nuk kanë qenë peygamber si: Taluti, Xhaluti, djemt e Ademit a.s., as'habul-Kehfi, Dhulkarnejni etj.

3. Rrëfime të cilat kanë ndodhur në kohën e Peygamberit a.s. si lufta e Bedrit, lufta e Uhudit, Israja e Mi'raxhi etj.

Dobitë e rrëfimeve kur'anore

Në rrëfimet kur'anore ka shumë dobi:

- Sqarimi themeleve të da'ves (thirrjes) në fe:

﴿٢٥﴾ وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا نُوحِي إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ

“Na, nuk kemi dërguar asnjë peygamber para teje e që të mos ia kemi shpallur atij: “S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj adhuromëni Mua!” (21:25)

- Përforcimi i zemrës së Peygamberit a.s. dhe ummetir të Muhammedit a.s. për të pranuar fenë islame:

﴿١٢٠﴾ وَكَلَّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقِّ وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى

﴿١٢٠﴾ لِلْمُؤْمِنِينَ

“Na po t’i tregojmë ty të gjitha lajmet e peygamberëve, për me ta forcua zemrën. Dhe në këtë sure të ka ardhur ty e vërteta; këshilla dhe të përkujtuarit për besimtarët.” (11:120)

- Vërtetimin e peygamberllëkut të peygamberëve të parë si dhe për t’i përkujtuar ata,

- Vërtetimin e peygamberllëkut të Muhammedit a.s. si dhe thirrjen e tij.

- Nxorrën në shesh falsifikimet e para që bënë ummetet e mëparshme:

﴿٩٣﴾ كُلُّ الطَّعَامِ كَانَ حَلَالًا لِبَنِي إِسْرَائِيلَ إِلَّا مَا حَرَّمَ إِسْرَائِيلُ عَلَى نَفْسِهِ مِنْ قَبْلِ أَنْ تُنَزَّلَ التَّوْرَةُ قُلْ فَأْتُوا

﴿٩٣﴾ بِالتَّوْرَةِ فَآتَوْهَا إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ

“Të gjitha ushqimet kanë qenë të lejuara për bijt e Israilit, përveç asaj që Israili ia ndaloi vetes para shpalljes së Teuratit. Thuaj (o Muhammed!): “Silleni Teuratin dhe lexonie nëse flisni të vërtetën!” (3:93)

- Rrëfimet kur'anore kanë përmbajtje edukative si:

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةً لِأُولِي الْأَلْبَابِ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَى وَلَكِنْ تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ

وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿١١١﴾

“Në tregimet e atyre (pejgamberëve) ka këshilla për ata që janë mendarë. Kur’ani nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i (librave) që janë shpallë para tij dhe shpjegues i çdo gjëje, dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin besimtarë.” (12:111)

Literatura e konsultuar:

1. Kur’ani – përkthim i Feti Mehdiut
2. Kasim Haxhiq, Božji poslanici – Sarajevo 1980.
3. Muhamed Halifa, Meal Iman fi rihabil-Kur’an, Kairo 1980
4. Muhamed Ebu Zehra, El-Mu’xhizetul-kubra-el-Kur’an ()
5. Muhamed Ali Sabuni, en-nubuvve vel enbija ()